

METO
MUHO

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8.34-1

M 98.




Në ato netët e beharit

81H-1
1798.

M E T O M U H O

NË ATO NETËT
E
BEHARIT



vjersha

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KORRIERI PARTIZAN

Nata ish e zezë, nata ish e eger,
çan korrieri natën, në xhep ka një letër.

Por ja, përmes drurësh po duken dy **hije**.
Ziniu nis mendon: «Mos duhet të shtie?»

Iu kujtua shtabi, shokët kur i thanë:
«Koha më nuk pret, luftrat këto kanë!»

Vrullshëm flakin bombat, nata bëhet **ditë**,
hiqet Ziniu zvarë, kalon nëpër pritë.

Ç'iu përgjak kraharori, letra ç'iu përgjak,
ecën nëpër natë, ecën nëpër flakë!

TE BURIMI

Një dit' vija fushëso
lodhur ë këputuro.
Pranë pishës u ndalova,
në burim syt' i freskova.
Kur ngrita kryet përpjetë,
ç'të shoh, vjen thëllëza vetë
me nja dy shtamba në duar
më këput me syt e shkruar.
Me dy-tri fjalë e ngacmova,
po e pash' që u shpejtova.
Ajo qeshi e më shikoi,
mori shtambat edhe shkoi.

1940.

A T E N T A T O R I

Nëna që të lindi,
kur të jepte gjinë,
të futi në gjak
ndjenjat për lirinë.

U rrite te shkëmbi
rrahur me furtunë,
në shi e në breshër,
me pushkë e me gunë.

Tmerr për tradhtarët
Tafili me trima,
në mes të qytetit
shkrep si vetëtima.

Lule Tafil Gjergji,
lule Kurveleshi,
dhe gjermani dridhej,
kur ti dilje sheshit.

Labja që të lindi
dhe që të dha gjinë,
rriti një luan,
trim për Shqipërinë.

KËNGËS KALABREZE!

Dridhen telat e lahutës,
dridhet çiftelia,
këng' e valle në podium,
lot valle Shqipëria.

Grupet vijnë valë-valë,
këngët ndjekin vallet,
në tribunë Kalabria
këndon e përmallet.

Nëpër këngë e nëpër valle
ku lahuta dridhet,
nga gëzimi e lumturia
Kalabria hidhet!

— Kanë shkuar pesqind vjet
që kur kam mërguar,
por jo, këngën shqipëtare
nuk e kam harruar!

1. Grupit të San Benetës të Kalabrisë iu dhurua emblema e Festivalit Folkloristik Kombëtar 1963.

1901 numri 12

DY PLAGË

Një merak i thellë Havanë e mundon,
dy plagë në zemër, gjoksi i gufon.
Për dritën e syve hyn e del n'avlli,
krisma të shurdhon, vetëtim e shi.
Luftë më cdo anë, gjaku shkon rrëke,
bien ndër beteja trimat për atdhe.
Dhe ja te rrugica dikush vjen ngadalë.
I shoqi me shokë, s'flasin asnjë fjalë.
Sa i pa Havaja, në fytyrë u pre.
— Ku është Mitati, djalin ku ma ke? —
Jahua i trishtuar i nxori nishanë,
kapelën me gjak, pushkën e gjerdanë.
Sa fillon tregimin ç'u bë në Mavrovë,
mes flakësh mbi tanke luanët u hodhë.
Fill në mes të fjalës vjen nga Prapanica
një shok e një shoqe, ca pleq nga Nivica.
I japin Havasë dhe mandatën tjetër:
«Aliu si Mitati, yll në mal ka mbetur!»
Pa po nëna labe tutje malet pa,

mposhti atë dhembje e shokëve u tha:
«Djemtë unë i linda si i do Shqipëria,
pa luftë e pa gjak s'fitohet liria.»

31 mars 1944.